



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL

Nr. 75/1 Prot.

Tiranë, më 09.02.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: KUJTIM TOPUZI
GAZETAR REPORT TV

Adresa elektronike: kujtimtopuzi@gmail.com

Në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar me nr.75 prot., datë 02.02.2026, kërkesa juaj për informacion në lidhje me ndryshimet në Kodin Penal, lidhur me paragrafin 7 të nenit 28.

1. Në lidhje me sa kërkon ju informojmë se me shkresat nr. 5078/2 prot., datë 14.10.2025 dhe nr. 5078/23 prot., datë 21.11.2025, Ministria e Drejtësisë ka përcjellë për mendim shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr.7895 datë 21.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

2. Lidhur me nenin 4 të projektligjit, që shfuqizon paragrafin e shtatë të nenit 28 të Kodit Penal "Forma të veçanta bashkëpunimi", jemi shprehur kundër heqjes së këtij parashikimi nga Kodi Penal. Kjo dispozitë ndryshe nga neni 52/a, ka në qendër bashkëpunimin me anëtarin e çdo strukture kriminale të organizuar në të gjitha format e veçanta të bashkëpunimit të parashikuara në Kodin Penal, si grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, banda e armatosur dhe organizata terroriste, me qëllim njohjen e bashkëpunësorëve, hierarkisë, pasurive dhe aktivitetit të tyre.

Nëse parashikimi i këtij paragrafi, vlerësohet më i përshtatshëm në dispozitat që lidhen me caktimin e dënimit, mund të rishikohet përfshirja në to, por në çdo rast pa cënuar përmbajtjen.

3. Lidhur me nenin 7 të projektligjit, i cili bën ndryshime në nenin 52/a të Kodit Penal "Përrjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunësorët e drejtësisë dhe viktimat", kemi vlerësuar se ka nevojë të rishikohet në tërësi. Kështu: përmbajtja e paragrafëve të tretë e të katërt duke integruar ndryshimet e propozuara në nenin aktual, do të ishte si vijon: *Personi që ka kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që heq dorë nga veprimtaria kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre u siguron autoriteteve administrative ose gjyqësore informacione të cilat ata përndryshe nuk do të kishin qenë në gjendje t'i siguronin ose, sipas rasti, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi, përveç personit që ka*

kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Fëmija i mitur i dëmtuar nga veprat penale, që kanë lidhje me shfaqjet pornografike me fëmijë, pornografinë e fëmijëve dhe prostitucionin e fëmijëve, përjashtohet nga dënimi.

Siç mund të vërehet, dispozita krijon shumë konfuzion i cili do të bënte të pazbatueshëm në praktikë një instrument që ka treguar se i shërben veprimtarisë hetimore.

Kështu, lidhur me paragrafin e tretë, në drejtim të ndërtimit të normës, gjykojmë se është i mbingarkuar, i paorganizuar sintaksisht dhe pa strukturë të qartë logjike.

Në aspektin substancial, problematikat janë të shumta ku mund të përmenden:

– kushti “që heq dorë nga veprimtaria kriminale”, në praktikë mund të interpretohet si një akt vullnetar pa mekanizëm verifikimi. Gjithashtu, nuk është në përputhshmëri me termat teknike që njeh Kodi Penal për heqjen dorë nga kryerja e veprës penale;

– zgjerohet bashkëpunimi përveçse me organet e ndjekjes penale edhe me autoritetet administrative dhe gjyqësore, ndërkohë që nuk qartësohet si u shërben këtyre organeve informacioni që jepet në shkëmbim të përfitimit nga përjashtimi ose ulja e dënimit: sipas propozimit mjafton të kalojë pragun e “i vështirë për t’u siguruar” pa përcaktuar rëndësinë e tij, siç parashikohet për shembull në paragrafin e shtatë të nenit 28, “ndihmesë që gjykohej vendimtare”;

– nuk është dhënë asnjë argument se përse vetëm veprat që lidhen me trafikun e lëndëve narkotike konsiderohen të një shkalle të tillë rrezikshmërie sa autori i tyre të mos përjashtohet nga dënimi, ndërkohë që vepra po aq apo më të rënda, që përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore dhe vepra të tjera objekt të organizatave kriminale si vrasje, rrëmbime, etj, nuk konsiderohen të tilla. Për më tepër, në praktikën shqiptare veprat penale të lidhura me narkotikët kanë peshën kryesore në veprimtarinë e krimit të organizuar. Heqja e këtij mekanizmi “ndihmë për përfitim”, u heq mundësinë autoriteteve për hetimin e plotë e të gjithëanshëm me qëllim zbulimin tërësor të veprimtarisë dhe bashkëpunëtorëve;

– në paragrafin e katërt, përveç termit “fëmijë i mitur”, i cili duhet të rishikohet kudo në draft, në tërësi parashikimit i mungon situata juridike për të cilën i mituri viktimë “përjashtohet nga dënimi”, ndërkohë që direktiva 2011/93 e përcakton qartazi kontekstin (*Shtetet Anëtare, në përputhje me parimet bazë të sistemeve të tyre ligjore, marrin masat e nevojshme për të siguruar që autoritetet kombëtare kompetente të kenë të drejtën të mos fillojnë ndjekje penale ose të mos vendosin dënime ndaj fëmijëve viktimë të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual, për shkak të përfshirjes së tyre në veprimtari kriminale të cilat ata janë detyruar t’i kryejnë si pasojë e drejtpërdrejtë e kryerjes ndaj tyre të ndonjë prej veprimeve të parashikuara në nenin 4, paragrafët (2), (3), (5) dhe (6), si dhe në nenin 5, paragrafi (6).”).*

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Kostaq Beluri

